



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË



SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Gusht 2016

Çfarë ka të Re në SHUKALB

Mundësia e Fundit për t'u Regjistruar në Kursin e Trajnimit "Plani i Biznesit për Përmirësimin e Performancës". Nxitoni!



SHUKALB ka kënaqësinë t'ju njoftojmë se cikili kursit të trajnimit "Plani i Biznesit për Përmirësimin e Performancës", do të fillojë në fillim të muajit shtator 2016.

Ky kurs trajnimi është vecanërisht i vlefshëm për drejtuesit e departamentit ekonomik, inxhinierik, shitjes dhe shërbimit me klientin.

Ne ju inkurajojmë që të nxitoni të regjistroheni, pasi në këtë raund të parë do të marrin pjesë vetëm **15 shoqëri ujësjellës kanalizime!**

Për më tepër informacion ju lutem lexoni [Broshuren](#).

Projekti "Zhvillimi Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri"

Angazhimi në Projekt i Ekspertëve Shqiptarë të Ujit



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike!

**2-3-4 Nëntor 2016,
Tiranë, Shqipëri**

Eventet e Ardhshme!

Plani i Biznesit për

Në përpjekje të përmbushjes së Objektivit të Misionit 4 të Strategjisë së Sektorit Shqiptar të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (2011-2017), dhe në veçanti të Prioritetit të Veprimi 4.a: " Hartimi i një programi kombëtar trajnimi dhe certifikimi, sipas kërkesave për trajnim të të gjithë shoqërive ujësjellës kanalizime", Projekti ka angazhuar ekspertët më të mirë lokalë në sektorin e ujit, të cilët vijnë nga institucione të ndryshme shqiptare, si universitete, shoqëri ujësjellës kanalizime, kompani konsulente dhe institucione qeveritare. Aspektet kryesore të angazhimit të ekspertëve lokalë në Projekt, konsiston në dhënien e mendimit mbi materialet e kursit, bazuar në zbatimin e saj në kuadër të kontekstit shqiptar dhe në sigurimin e rasteve të studimeve të dokumentuara dhe shembuj nga përvoja e tyre Shqiptare dhe/ose e Ballkanit Perëndimor për pasurimin e materialit të kursit të trajnimit. [lexo më shumë](#)

Profesionistët e Rinj të Ujit

Arlinda Ibrahimllari, UK Korçë, Zgjidhet Kryetare e Komitetit Drejtues për Zhvillimin e Udhëheqësve të Ujit të IWA-së



SHUKALB me krenari njofton se Znj. Arlinda Ibrahimllari është përzgjedhur Kryetarja e re e Komitetit Drejtues për Zhvillimin e Udhëheqësve të Ujit të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA) për periudhën shtator 2016 – shtator 2018. E thënë më thjesht, Arlinda

është ngritur duke u zgjedhur nga kolegët e saj ndërkombëtarë për t'i udhëhequr ata si Profesionistja e Re e Ujit më e mirë në Botë. [lexo më shumë](#)

Baseni i Drinit – Burim i Përbashkët – Përgjegjësi e Përbashkët



SHUKALB ka nisur fazën e dytë të projektit të titulluar " Baseni i Drinit * Burim i Përbashkët * Përgjegjësi e Përbashkët". Ky projekt bëhet në bashkëpunim të Grupit Profesionistët

Përmirësimin e Performancës - Shtator 2016

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



e Rinj të Ujit (PRU) të Shqipërisë, dhe një grup studentësh nga Instituti Politeknik i Worcester (WPI) (SHBA). Qëllimi kryesor ishte për të hartuar një program për të rritur ndërgjegjësimin mbi lumin Drin si një burim i çmuar natyror, si dhe për të ngritur ndërgjegjësimin mbi çështjet e mjedisit në lidhje me lumin.[lexo më shumë](#)

Lajme nga Anëtarët tanë

Intervistë me Z. Kujtim Katroshi, Përgjegjës i IPUN, UK Kavajë



Duke marrë shkas nga tema e sivjetshme e Konferencës dhe Ekspozitës së Përbashkët Ballkanike, “Uji dhe Punësimi”, SHUKALB do të publikojë artikuj të

veçantë ku në fokus do të jenë punonjës nga shoqëritë ujësjellës kanalizime anëtare të shoqatës, si një hapësirë e dedikuar ku mund të përshkruajnë karrierën e tyre në sektor. Këtë muaj është përzgjedhur për t’u intervistuar Z. Kujtim Katroshi nga Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kavajë. Z. Katroshi është 61 vjeç, me profesion Bio-Kimist dhe aktualisht ushtron detyrën e Përgjegjës të Impiantit të Përpunimit të Ujërave të Ndotur, UK Kavajë.[lexo më shumë](#)

Të tjera

SHUKALB Përfshihet Aktivisht në Nismën e Zhvillimit të Kapaciteteve Bashkëpunuese për Evropën Juglindore

Më datë 13 korrik, SHUKALB ishte pjesë e seminarit të tretë të Projektit ” Nisma e Zhvillimit të Kapaciteteve Bashkëpunuese për Përmirësimin e Shpërndarjes së Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Evropën Juglindore”, i financuar nga Agjencia Gjermane për Zhvillim (GIZ) dhe Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SECO), në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë. SHUKALB u përfaqësua nga Znj. Elisabeta Poçi, Zëvendës Drejtore Ekzekutive dhe Znj. Olta Ceca, Menaxhere e Programeve dhe Trajnimeve.[lexo më shumë](#)

Konferenca Ndërkombëtare e Specialistëve – IWA

Efficient2017



SHUKALB sjell në vëmendjen e anëtarëve të saj se Shoqata Ndërkombetare e Ujit (IWA) njofton se Konferenca e nëntë biennale – IWA Efficient2017, e organizuar nga Grupi Specialist i Menaxhimit Eficient të Ujit Urban (Efficient Urban Water Management Specialist Group) i IWA-së, do të mbahet në datat 21-23 mars, 2017, në Tel Aviv, Izrael. [lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, Web: www.shukalb.al